



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/15
Datë: 27.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Shtohet lista e mallrave në Aneksin A të Ligjit Nr. 03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë, me normë të tatimit të akcizës si në vijim:
 - 1.1. Për qumështin e koncentruar nga kreu tarifor 0402, vendoset norma e tatimit të akcizës në shumën prej pesëdhjetë centësh (0.50€) për një (1) kilogram neto.
2. Obligohen Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky Vendim i dërgohet Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për konsultim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/15
Datë: 27.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në paragrafin 4, të nenit 48, të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 14, paragrafi 2, të Rregullores Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Lista e anëtarëve potencialë të Komisionit Shtetëror të Pranimit për Kategorinë e Lartë Drejtuese.
2. Obligohet Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike për zbatim të këtij Vendimi.
3. Si pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Lista e anëtarëve potencialë të Komisionit Shtetëror të Pranimit për Kategorinë e Lartë Drejtuese.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Listën e propozuar të kandidatëve potencialë për anëtarë të Komisionit të Pranimit në Kategorinë e Lartë Drejtuese në Administratën Shtetërore.

Lista e kandidatëve potencialë për anëtarë të Komisionit të Pranimit në Kategorinë e Lartë Drejtuese në Administratën Shtetërore				
Nr	Emri & mbiemri	Institucioni	Pozita e punës	Mbarimi i mandatit
1.	Fadile Dyla	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Sekretare e Përgjithshme	12.12.2026
2.	Naim Gashi	Agjencia e Kosovës për Akreditim/ Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Drejtor i Përgjithshëm	07.03.2027
3.	Venera Çerkini	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Sekretare e Përgjithshme	21.02.2027
4.	Anita Alaj Kalanderi	Ministria e Drejtësisë	Sekretare e Përgjithshme	11.07.2027
5.	Bislim Bislimi	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Sekretar i Përgjithshëm	07.11.2027
6.	Ilir Muçaj	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	Sekretar i Përgjithshëm	12.06.2028
7.	Jeton Qela	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Sekretar i Përgjithshëm	13.08.2028
8.	Genç Metaj	Ministria e Punëve të Brendshme	Sekretar i Përgjithshëm	22.09.2028
9.	Arben Krasniqi	Zyra e Kryeministrit të Kosovës	Sekretar i Përgjithshëm	26.11.2028
10.	Vedat Maxhuni	Ministria për Komunitete dhe Kthim	Sekretar i Përgjithshëm	17.12.2028
11.	Avni Kastrati	Agjencia e Statistikave të Kosovës	Drejtor Ekzekutiv	09.01.2029
12.	Lyra Osmani	Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm/ Zyra e Kryeministrit të Kosovës	Inspektore e Përgjithshme	09.01.2029
13.	Arton Ahmeti	Ministria e Financave	Sekretar i Përgjithshëm	30.01.2029
14.	Edi Gusia	Agjencia për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeministrit të Kosovës	Drejtoreshë Ekzekutive	25.02.2029
15.	Leonita Shabani-Mullarama	Ministria e Ekonomisë	Sekretare e Përgjithshme	25.02.2029

16.	Irfa Lipovica	Drejtoria e Akreditimit të Kosovës/ Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit	Drejtor i Përgjithshëm	25.03.2029
17.	Besa Bytyqi	Inspektorati i Arsimit/Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Drejtoresh e Përgjithshme në Inspektoratin e Arsimit	28.05.2029
18.	Labinot Zeqiri	Inspektorati Qendror/ Ministrinë e Shëndetësisë	Kryeinspektor në Inspektoratin Qendror të Shëndetësisë	28.05.2029
19.	Illysen Muzliukaj	Instituti i Kosovës për Administratë Publike/ Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike	Drejtor i Përgjithshëm	31.07.2029
20.	Jetmir Haziri	Agjencia e Regjistrimit Civil	Drejtor Ekzekutiv	12.11.2029



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/15
Datë: 27.04.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/-L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për Amendamentin Nr. 2 të Marrëveshjes Financiare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, për Programin "IPA 2019", pjesa e parë.
2. Kontributet financiare të Republikës së Kosovës, të parapara në kuadër të Amendamentit Nr. 2 të Marrëveshjes Financiare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin "IPA 2019", pjesa e parë, do të transferohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës drejtpërdrejt, ose nëpërmjet Korporatës Energjetike e Kosovës.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për ndërmarrjen e hapave, konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë